



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 23
MAJ 2008**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA ODRŽANE
23. MAJA 2008. GODINE**

**Maj – Maja
2008**

R e n d i i d i t ë s

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.

D n e v n i r e d:

1. Drugo razmatranje Nacrt zakona o službenim praznicima u Republici Kosova.

A g e n d a:

1. Second reading of the Draft Law on Official Holidays in Republic of Kosovo.

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 23 MAJ 2008

Seanca plenare filloi punën në orën 10,00.

Seancën plenare e kryesoi Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Para se të fillojmë punën, ju njoftoj se, me vendim të shefit të UNMIK-ut, prej sot deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës është deputeti Dragan Dimiq.

Në sallë janë të pranishëm 94 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Po ashtu, ju njoftoj se, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me të, sipas procedurës së veçantë, datë 15 shkurt 2008, në seancën e sotme plenare do të procedohet me leximin e dytë të Projektligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.

Ftoj kryesuesin e Komisionit ad-hoc, zotëri Fehmi Mujota që të paraqet rekomandimin e Komisionit.

FEHMI MUJOTA: Zoti Kryetar,

Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Deputetë të nderuar,

Komisioni ad-hoc, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës, datë 25 shkurt 2008, në mbledhjen e mbajtur më 22 dhe 23 maj 2008, shqyrtoi Projektligjin për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, të propozuar nga Qeveria dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqet këtë:

R A P O R T

Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për festat zyrtare në Republikën e Kosovës dhe njëzëri ka vendosur që t'i rekomandojë Kuvendit për miratim të Projektligjit, me amendamentet e propozuara, si në vijim.

Para se t'i lexoni amendamentet ju që i keni para veti dhe, natyrisht, para se ta aprovojme këtë ligj në tërësi, më lejon që në emër të Komisionit ad-hoc, të falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit për kontributin e dhënë në punën e lodhshme dhe të gjatë për të

gjetur një kompromis dhe të falënderoj për përpjekjet e tyre për të mbajtur një frymë konsensuale në mes të pakicës dhe shumicës, në mes të partive parlamentare dhe, natyrisht, në raport me interesat e qytetarëve të vendit për shënimin e këtyre datave.

Përpjekjet e Komisionit ad-hoc kanë qenë në frymën e parimit të obligimeve, të cilat i ka marrë Kuvendi i Kosovës prej datës 17 shkurt 2008 me shpalljen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran dhe në frymën e asaj që kemi aprovuar këtë mocion për të aprovuar ligjet që dalin nga Pakoja gjithëpërfshirëse.

Është bërë ajo që ka qenë më e mundshme dhe më e mira për momentin e caktuar, si një formë kompromisi në mes mocionit që është menduar në nenin 2 pika 2 dhe në mes të asaj që të mos ketë asnjë ndryshim në Ligj.

Prandaj, kompromisi është në pikën 5 pika 5, në të cilin i kemi përfshirë edhe festat që shënohen me krenari, do të them, edhe nga shumica edhe nga pakica.

Keni dy mocione, përkatësisht dy amendamente në këtë rast. Njëri nuk ka të bëjë me ndryshim thelbësor, përveç se data e Kushtetutës precizohet si datë 9 prill dhe një tjetër, që zëvendësohet numri 6 me numrin 7. Ndërsa, festat e renditura i keni sipas asaj që edhe jemi dakorduar në Komision: datën e 28 nëntorit si Ditë e Shqiptarëve, 12 qershori - Ditë e Paqes, 6 marsi - Ditë e Përkujtimit dhe Respektit për Veteranët, si dhe kemi festat për pakicat, në këtë rast: 23 prilli - Ditë e Turqve, 8 prill - Ditë e Romëve, 15 shkurti - Ditë e Hashkalinjve, 28 shtatori - Ditë e Boshnjakëve, 6 maj - Ditë e Goranëve dhe ditët e tjera memoriale përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në konsultim me Presidentin e Republikës së Kosovës, nga të cilat, dy ditë - në konsultim me komunitetin serb të Kosovës. Kjo është çështje që do të rregullohet më vonë, në konsultim me Këshillin e komunitetit serb.

Ky është raporti i prezantuar dhe kërkojmë nga Seanca që të aprovojë Ligjin me ndryshimet, përkatësisht me amendamentet e ofruara. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Shefat e grupeve parlamentare ose kuvendare, nuk janë të paraqitur për diskutim.

Kalojmë në votim dhe miratim të amendamenteve.

Konstatohet se në sallë janë 94 deputetë.

Amendamenti 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin. Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, 20 “kundër”, 8 abstenime – miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 44 vota “për”, 28 “kundër”, 12 abstenime – miratohet amendamenti 2.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim të tekstit të Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tash:

Konstatohet se me 46 vota “për”, 32 “kundër” dhe 9 abstenime – miratohet Ligji në tërësi.

Me këtë votim, përfundon punën seanca e sotme.

Mirupafshim në seancën e ardhshme!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve